Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më

vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të siguruar*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës*] / është garantuar pranë [*emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit*] me një vlerë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nëshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti i këtij shërbimi është përgatitja dhe shpërndarja e ushqimit të gatuar për **Qendrën Komunitare Multidisiplinare**, me kapacitet **50 (pesëdhjetë) racione ushqimore në ditë**, për vaktin e drekës, **nga e hëna deri të shtunën**, sipas menuve ditore dhe javore të miratuara dhe të përcaktuara në këto dokumente.

Bazuar në Urdhër 293 datë 31.07.2025 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqim në institucionet publike rezidenciale e komunitare të perkujdesjes shoqërore” është përcaktuar Niveli I kuotave financiare në qendrat ditore polivalente 310 leke.

Shërbimi do të realizohet në përputhje me normën bazë të ushqimit, kërkesat për sigurinë ushqimore, si dhe kushtet e menaxhimit dhe kontrollit të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

1. Operatori ekonomik duhet të sigurojë dhe të disponojë në ambientet e kuzhinës mjete matëse të sasisë, të certifikuara nga Inspektorati i Kalibrimit të Njësive Matëse.
2. Çdo ditë, përfaqësuesit e operatorit ekonomik do të rakordojnë me personin e ngarkuar nga Titullari i Qendrës Komunitare lidhur me:
 - forcën ditore të ushqimit;
 - konsumin ditor të ushqimit.
3. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë të transferojë ose nënkontrakttojë detyrimet kontraktuale pa pëlqimin paraprak dhe me shkrim të Autoritetit Kontraktor.
4. Operatori ekonomik do të paraqesë, në fund të çdo muaji, faturën dhe dokumentacionin justifikues për sasinë e racioneve ushqimore të realizuara.

KËRKESA TEKNIKE PËR PËRGATITJEN E USHQIMIT DHE SIGURINË USHQIMORE

A. Siguria Ushqimore

1. Të gjithë artikujt ushqimorë që përdoren për gatim duhet të jenë të freskët dhe në përputhje me specifikimet teknike për lëndët e para të përcaktuara në këtë dokument.
2. Ushqimi duhet të gatuhet në çast. Racioni ditor duhet të përmbajë sasi të duhura sipas menuse ditore dhe javore. Ushqimi shpërndahet i ngrohtë, sipas orareve të përcaktuara nga Administrata e Qendrës Komunitare.
3. Në asnjë rast nuk lejohet zëvendësimi i artikujve ushqimorë të përcaktuar në normën bazë të ushqimit, përveç rasteve të fatkeqësive natyrore ose të forcës madhore.
4. Personeli që realizon përgatitjen e ushqimit duhet të jetë i kualifikuar profesionalisht dhe të respektojë rregullat higjieno-sanitare në fuqi.

MENAXHIMI DHE KONTROLLI I SHËRBIMIT NGA AUTORITETI KONTRAKTOR

1. Autoriteti Kontraktor do të verifikojë çdo ditë numrin e personave që trajtohen me ushqim (forca ditore), për **50 racione ushqimore**.
2. Autoriteti Kontraktor do të kontrollojë:
 - respektimin e orarit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit;
 - zbatimin e normave të racioneve ushqimore;
 - pastërtinë e ambienteve të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit.
3. Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet komisionit të ngritur me urdhër të Titullarit, do të regjistrojë sasinë ditore të racioneve të ardhura. Likuidimi i detyrimeve ndaj operatorit ekonomik do të kryhet sipas urdhrit përkatës të Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

PROGRAMI USHQIMOR

1. Operatori ekonomik është i detyruar të zbatojë planin e menisë ditore dhe javore të ushqimit, sipas programit ushqimor të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.
2. Programi ushqimor duhet të sigurojë sasinë dhe cilësinë e ushqimit, në përputhje me normën bazë të ushqimit dhe me kërkesat e përcaktuara në këto specifikime teknike.
3. Operatori ekonomik duhet të disponojë mjete transporti të përshtatshme për transportin e produkteve ushqimore të freskëta dhe të gatuar, që plotësojnë kushtet higjeno-sanitare sipas legjislacionit në fuqi.
4. Menuja ditore përmban: Karbohidrate (oriz, makarona, patate)

Proteina shtazore dhe bimë (pulë, mish, vezë, bishtajore)

Perime dhe fruta sezonale

Bukë dhe ujë

Kjo strukturë garanton një ushqyerje të balancuar, të sigurt dhe të përshtatshme për moshën e fëmijëve, duke respektuar kufirin buxhetor dhe standardet higjeno-sanitare.

5. Sebashku me racionet ushqimore operatori ekonomik do të sjellë dhe uje të pijshëm ku sipas perlllogaritjeve duhet të sjellë çdo ditë 12 shishe uje 1.5 litra i ambalazhuar .

GRAMATURAT

MENU nr 1

Gjellë fasule

Përbërësi	Sasia
Fasule të thata	60 gr
Qepë	15 gr
Vaj luledielli / ulliri	5 gr
Salcë domate	20 gr
Kripë	1 gr

Përbërësi	Sasia
------------------	--------------

Erëza të lehta (dafinë) sasi minimale

rreth **200 gr gjellë të gatuar**

Pilaf

Përbërësi	Sasia
------------------	--------------

Oriz i bardhë (i thatë) 40 gr

Vaj 5 gr

Kripë 1 gr

Ujë sipas nevojës

rreth **120–130 gr pilaf të gatuar**

Sallatë domate – kastravec

Përbërësi Sasia

Domate 40 gr

Kastravec 40 gr

Vaj ulliri 5 gr

Limon 5 gr

Kripë 0.5 gr

Bukë

Përbërësi	Sasia
------------------	--------------

Bukë e bardhë / integrale 50 gr

Frut i stinës

Përbërësi Sasia

Frut sezonal 120 gr

Kos

Përbërësi Sasia

Kos natyral 150 gr

MENU Nr. 2

Makarona me salcë domate & mish të grirë (vici)

Përbërësi	Sasia
------------------	--------------

Makarona të thata 60 gr

Mish vici i grirë 60 gr

Salcë domate 80 gr

Vaj ulliri / luledielli 5 gr

Qepë 10 gr

Kripë 1 gr

Përbërësi	Sasia
-----------	-------

Erëza të lehta (borzilok) sasi minimale

rreth **200–220 gr** pjatë të gatuar

Sallatë lakër – karrotë

Përbërësi	Sasia
Lakër e bardhë	40 gr
Karrotë	20 gr
Vaj ulliri	5 gr
Limon / uthull molle	5 gr
Kripë	0.5 gr

Bukë

Përbërësi	Sasia
Bukë e bardhë / integrale	50 gr

Frut i stinës

Përbërësi	Sasia
Frut sezonal	120 gr

Kos

Përbërësi	Sasia
Kos natyral	150 gr

MENU 3

Gjellë me patate

Përbërësi	Sasia
Patate	80 gr
Karrotë	20 gr
Qepë	10 gr
Vaj ulliri / luledielli	5 gr
Kripë	1 gr
Ujë	sipas nevojës

rreth **150–160 gr** gjellë të gatuar

Fileto pule

Përbërësi	Sasia
Mish pule i filetuar	80 gr
Vaj ulliri / luledielli	5 gr
Kripë	1 gr
Erëza të lehta (rigon)	sasi minimale

rreth **80 gr mish të gatuar**

Sallatë jeshile

Përbërësi	Sasia
Marule	50 gr
Karrotë	20 gr
Vaj ulliri	5 gr
Limon / uthull	5 gr
Kripë	0.5 gr

Bukë

Përbërësi	Sasia
Bukë e bardhë / integrale	50 gr

Bukë

Përbërësi	Sasia
Bukë e bardhë / integrale	50 gr

Frut i stinës

Përbërësi	Sasia
Frut sezonal (mollë, dardhë, banane)	120 gr

MENU 4

Gjellë thjerrëza

Përbërësi	Sasia
Thjerrëza të thata	60 gr
Qepë	15 gr
Karrotë	20 gr
Vaj luledielli / ulliri	5 gr
Salcë domate	20 gr
Kripë	1 gr
Erëza të lehta (dabinë)	sasi minimale
Ujë	sipas nevojës

rreth **200 gr gjellë të gatuar**

Pilaf

Përbërësi	Sasia
Oriz i bardhë (i thatë)	40 gr
Vaj	5 gr

Përbërësi	Sasia
Kripë	1 gr
Ujë	sipas nevojës

rreth **120–130 gr pilaf të gatuar**

Sallatë ulliri

Përbërësi	Sasia
Ullinj të zinj / jeshil (pa bërthamë)	40 gr
Vaj ulliri	5 gr
Limon / uthull molle	5 gr

Bukë

Përbërësi	Sasia
Bukë e bardhë / integrale	50 gr

Frut i stinës

Përbërësi	Sasia
Frut sezonal (mollë, dardhë, banane)	120 gr

MENU Nr. 5

Supë krem me mish pule

Përbërësi	Sasia
Mish pule (pa kockë)	60 gr
Patate	50 gr
Karrotë	30 gr
Qepë	10 gr
Vaj luledielli / ulliri	5 gr
Kripë	1 gr
Ujë	sipas nevojës

rreth **200 ml supë krem të gatuar**

PËrime të ziera (brokoli, lulelakër, karrotë)

Përbërësi	Sasia
Brokoli	40 gr
Lulelakër	40 gr
Karrotë	30 gr
Vaj ulliri	5 gr
Limon	5 gr
Kripë	0.5 gr

Bukë**Përbërësi Sasia**

Bukë e bardhë / integrale 50 gr

Frut i stinës**Përbërësi Sasia**

Frut sezonal (mollë, dardhë, banane) 120 gr

MENU Nr. 6**Pastiçe me makarona, qumësht, vezë dhe djathë****Përbërësi Sasia**

Makarona të thata	40 gr
Qumësht	80 ml
Vezë	1 copë (rreth 50 gr)
Djathë i bardhë / i butë	30 gr
Vaj / gjalp	5 gr
Kripë	0.5 gr

rreth **150–160 gr** pastiçe të gatuar

Qofte me mish vici**Përbërësi Sasia**

Mish vici i grirë	70 gr
Bukë e tharë / miell për mbushje	10 gr
Vezë	10 gr
Kripë	1 gr
Erëza të lehta (rigon, majdanoz)	sasi minimale

rreth **80 gr** qofte të gatuar

Sallatë fshati**Përbërësi Sasia**

Domate	40 gr
Kastravec	40 gr
Karrotë	20 gr
Vaj ulliri	5 gr
Limon / uthull	5 gr
Kripë	0.5 gr

Frut i stinës

Përbërësi	Sasia
Frut sezonal (mollë, dardhë, banane)	120 gr

MENU 7

Rizoto me perime

Përbërësi	Sasia
Oriz i bardhë (i thatë)	50 gr
Karrotë	20 gr
Qepë	10 gr
Brokoli	20 gr
Vaj ulliri / luledielli	5 gr
Kripë	1 gr
Ujë / lëng perimesh	sipas nevojës

rreth **150–160 gr rizoto të gatuar**

Qofte me mish vici në lëng

Përbërësi	Sasia
Mish vici i grirë	70 gr
Bukë e thatë / miell për mbushje	10 gr
Vezë	10 gr
Kripë	1 gr
Erëza të lehta (rigon, majdanoz)	sasi minimale
Ujë / lëng perimesh	sipas nevojës

rreth **80 gr qofte të gatuar me lëng**

Sallatë lakër

Përbërësi	Sasia
Lakër e bardhë	50 gr
Karrotë	20 gr
Vaj ulliri	5 gr
Limon / uthull	5 gr
Kripë	0.5 gr

Bukë

Përbërësi	Sasia
Bukë e bardhë / integrale	50 gr

Frut i stinës

Përbërësi	Sasia
Frut sezonal (mollë, dardhë, banane)	120 gr

MENU Nr. 8

Supë krem patate – karrota

Përbërësi	Sasia
Patate	50 gr
Karrotë	30 gr
Qepë	10 gr
Vaj ulliri / luledielli	5 gr
Kripë	1 gr
Ujë	sipas nevojës

rreth 200 ml supë krem të gatuar

Byrek me gjizë

Përbërësi	Sasia
Brumë (miell)	50 gr
Gjizë	40 gr
Vaj / gjalp	5 gr
Kripë	0.5 gr

rreth 150–160 gr byrek të gatuar

Sallatë fshati

Përbërësi	Sasia
Domate	40 gr
Kastravec	40 gr
Karrotë	20 gr
Vaj ulliri	5 gr
Limon / uthull	5 gr
Kripë	0.5 gr

Bukë

Përbërësi	Sasia
Bukë e bardhë / integrale	50 gr

Frut i stinës

Përbërësi	Sasia
Frut sezonal (mollë, dardhë, banane)	120 gr

MENU Nr. 9

Supë perimesh

Përbërësi	Sasia
Karrotë	30 gr
Patate	40 gr
Qepë	10 gr
Kungull / zucchini	20 gr
Vaj ulliri / luledielli	5 gr
Kripë	1 gr
Ujë	sipas nevojës

rreth **200 ml supë të gatuar**

Makarona me salcë

Përbërësi	Sasia
Makarona të thata	60 gr
Salcë domate	80 gr
Vaj ulliri	5 gr
Kripë	1 gr
Erëza të lehta (borzilok) sasi minimale	

rreth **150–160 gr pjatë të gatuar**

Bukë

Përbërësi	Sasia
Bukë e bardhë / integrale	50 gr

Frut i stinës

Përbërësi	Sasia
Frut sezonal (mollë, dardhë, banane)	120 gr

MENU NR 10

Bizele me mish vici

Përbërësi	Sasia
Bizele të ngrira / të freskëta	60 gr
Mish vici i grirë	60 gr
Qepë	10 gr
Karrotë	20 gr
Vaj ulliri / luledielli	5 gr
Kripë	1 gr
Ujë	sipas nevojës

rreth **150–160 gr gjellë të gatuar**

Speca të mbushur

Përbërësi	Sasia
Speca të kuq / të verdhë	60 gr
Mish vici i grirë	40 gr
Oriz	20 gr
Qepë	10 gr
Vaj ulliri / luledielli	5 gr
Kripë	1 gr

rreth **120–130 gr speca të mbushur të gatuar**

Bukë

Përbërësi	Sasia
Bukë e bardhë / integrale	50 gr

Frut i stinës

Përbërësi	Sasia
Frut sezonal (mollë, dardhë, banane)	120 gr

MENU Nr. 11

Pilaf

Përbërësi	Sasia
Oriz i bardhë (i thatë)	50 gr
Vaj luledielli / ulliri	5 gr
Kripë	1 gr
Ujë	sipas nevojës

rreth **150 gr pilaf të gatuar**

Pulë e pjekur në furrë

Përbërësi	Sasia
Mish pule (pa kockë)	90 gr
Vaj ulliri / luledielli	5 gr
Kripë	1 gr
Erëza të lehta (rigon)	sasi minimale

rreth **80 gr mish të pjekur neto**

Sallatë jeshile

Përbërësi	Sasia
Marule jeshile	45 gr

Përbërësi	Sasia
-----------	-------

Vaj ulliri	5 gr
Limon	5 gr
Kripë	0.5 gr

Frut i stinës

Përbërësi	Sasia
-----------	-------

Frut sezonal (mollë/dardhë/banane)	120 gr
------------------------------------	--------

Kos

Përbërësi	Sasia
-----------	-------

Kos natyral	150 gr
-------------	--------

MENU 12**Sanduiç me fileto pule**

Përbërësi	Sasia
-----------	-------

Bukë e bardhë / integrale	70 gr
Fileto pule e pjekur	60 gr
Patate e zier / e pjekur	40 gr
Domate	20 gr
Kastravec	20 gr
Salcë (jogurt / majonezë e lehtë)	5 gr

rreth **215–220 gr sanduiç të përgatitur**

Kos

Përbërësi	Sasia
-----------	-------

Kos natyral	150 gr
-------------	--------

Frut i stinës

Përbërësi	Sasia
-----------	-------

Frut sezonal (mollë, dardhë, banane)	120 gr
--------------------------------------	--------

Ëmbëlsirë

Përbërësi	Sasia
-----------	-------

Kek / sultjash / strudel	40–50 gr
--------------------------	----------

MENU 13**Purë me qofte**

Përbërësi	Sasia
-----------	-------

Patate	100 gr
Gjalp / vaj ulliri	5 gr

Përbërësi	Sasia
Qofte me mish vici	70 gr
Kripë	1 gr
Erëza të lehta (rigon, majdanoz) sasi minimale	

rreth 170–180 gr purë me qofte të gatuar

Supë perimesh

Përbërësi	Sasia
Karrotë	30 gr
Patate	40 gr
Qepë	10 gr
Kungull / zucchini	20 gr
Vaj ulliri / luledielli	5 gr
Kripë	1 gr
Ujë	sipas nevojës

rreth 200 ml supë të gatuar

Sallatë lakër

Përbërësi	Sasia
Lakër e bardhë	50 gr
Karrotë	20 gr
Vaj ulliri	5 gr
Limon / uthull	5 gr
Kripë	0.5 gr

Bukë

Përbërësi	Sasia
Bukë e bardhë / integrale	50 gr

Frut i stinës

Përbërësi	Sasia
Frut sezonal (mollë, dardhë, banane)	120 gr

MENU 14

Picë personale me salcë domate dhe proshutë pule

Përbërësi	Sasia
Brumë për picë	70 gr
Salcë domate (e bërë vetë)	30 gr

Përbërësi	Sasia
Djathë (i shkrifët / mozzarella)	30 gr
Proshutë pule	40 gr
Vaj ulliri / gjalp	5 gr

rreth **170–175 gr** picë të gatuar

Sallatë miks

Përbërësi	Sasia
Marule	30 gr
Domate	30 gr
Kastravec	20 gr
Karrotë	20 gr
Vaj ulliri	5 gr
Limon / uthull	5 gr
Kripë	0.5 gr

rreth **110 gr** sallatë miks

Kos

Përbërësi	Sasia
Kos natyral	150 gr

Frut i stinës

Përbërësi	Sasia
Frut sezonal (mollë, dardhë, banane)	120 gr

Ëmbëlsirë – Strudel molle

Përbërësi	Sasia
Strudel molle	40–50 gr

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Qendra Komunitare do të njoftojë në orën 09: 30 për numrin e saktë të racionevë dhe të produkteve shtesë që do të porositen.
2. Qendra Komunitare do të furnizohet me Ushqim të Gatshëm nga e hena në te shtunë brenda orës 12.00 pranë ambjenteve të qëndrës.
3. Qendra Komunitare ne varesi te orarit te shkolles se femijeve qe frekuentojne sherbimet, mund te kerkoj qe disa racione te kthehen ne vakte mengjesi.
4. Qendra do të pajiset çdo ditë me një faturë tatimore ku do të cilësohen numri i menuve të mara në dorëzim , çmimi si dhe vlera e ushqimit të sjellë

Shtojca 7.

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Ushqimi që do vije në Qender do të jetë i gatuar, i paketuar hermetikisht dhe të ruhet në kushte të mira higjienore sanitare gjatë transportit. Sebashku me racionet ushqimore operatori ekonomik do të sjellë dhe ujë të pijshëm ku sipas përlogaritjeve duhet të sjellë çdo ditë 12 shishe ujë 1.5 litra .

AFATET E EKZEKUTIMIT: Nga momenti i lidhjes së kontratës, për 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Qendra Komunitare Multidisiplinare, Bashkia Tiranë

Menutë e mëposhtë do të shpërndahen në ditë të ndryshme gjatë javës. Operatori ekonomik është i detyruar të zbatojë keto menu:

Menu 1	Menu 2	Menu 3	Menu 4	Menu 5	Menu 6
Gjellë fasule	Bizele me mish vici	Gjellë me patate	Gjellë Thjerrëza	Supe krem me mish pule	Pastice(qumesht veze, djath)
Pilaf	Specatë mbushur	Fileto pule	Pilaf	Perime të ziera (Brokol, Lulelaker, Karrote) Te marinuara me vaj ulliri dhe limon.	Qofte me mish vici
sallatë domate-kastravec		Sallatë jeshile	sallatë ulliri		Sallatë fshati
bukë	bukë	bukë	bukë	bukë	bukë
Frut i stines	Frut i stines	Frut i stines	Frut i stines	Frut i stines	Frut i stines
Kos	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos

Menu 7	Menu 8	Menu 9	Menu 10	Menu 11	Menu 12	Menu 13	Menu 14
Rizoto me perime	Supe krem patate karrota	Supe perime	Makarona me salcë domate & mish të grirë(vici),	Pilaf	Sanduic me fileto pule,patate, salce, domate ,kastravec	Pure me qofte	Pica personale (me salce domate te bere vete) proshute pule.
Qofte(mish vici) me leng	Byrek me gjize	Makarona me salce	sallatë lakër-karrotë	Pulë e pjekur ne furre	Kos	Supe perime	Sallate miks
Sallate laker	Sallate fshati			Sallate jeshile	Frut I stines	Sallate laker	Kos
bukë	bukë	bukë	bukë	bukë	Embelsire /Kek/ Sultjash/ strudel	Buke	Frut I stines
Frut stines I	Frut stines I	Frut stines I	Frut stines I	Frut stines I	Sanduic me fileto pule,patate, salce, domate ,kastravec	Frut I stines	Embelsire Strudel molle.
Kos	Kos	Kos	Kos	Kos		Pure me qofte	

Ne Muajt e veres pervec Menuve te mesiperme do te nderthuren dhe me menu specifike te stines si me poshte:

Menu 15	Menu 16	Menu 17
Gjelle bamje mish	Turli	Gjelle Verore
Pilaf	Tarator	Byrek qepe domate
Buke	Sallate fshati	Kos
Sallate jeshile	Buke	Sallate ullinj
Frut	Frut	Buke

Me kerkese te autoritetit kontraktor sipas rasteve ,mund te kerkohet vakt mengjesi ne vend te vaktit te drekes, i cili do te permbaje:

Menu 1	Menu 2	Menu 3	Menu 4	Menu 5
Qumesht 200 ml	Vezë 1 copë	Gjalp personal	Qumësht 200 ml	Reçel personal (kutia e vogël)
Buke 1 fete 60-70 gr	Bukë 60 gr	Qumësht	Biskota të thjeshta, 2-3 copë	Bukë
Djathe 30-40 gr	Reçel personal(I paketuar) 10-15 gr	Bukë	Qumësht 200 ml	Qumësht 200 ml
Frut sezonal	Vezë 1 copë	Gjalp personal	Biskota të thjeshta, 2-3 copë	Reçel personal (kutia e vogël)

Shtojca 8.

TERMAT E REFERENCES

Objekti i këtij shërbimi është përgatitja dhe shpërndarja e ushqimit të gatuar për **Qendrën Komunitare Multidisiplinare**, me kapacitet **50 (pesëdhjetë) racione ushqimore në ditë**, për vaktin e drekës, **nga e hëna deri të shtunën**, sipas menuve ditore dhe javore të miratuara dhe të përcaktuara në këto dokumente.

Bazuar në Urdhër 293 datë 31.07.2025 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqim në institucionet publike rezidenciale e komunitare të perkujdesjes shoqërore” është përcaktuar Niveli I kuotave financiare në qendrat ditore polivalente 310 leke.

Shërbimi do të realizohet në përputhje me normën bazë të ushqimit, kërkesat për sigurinë ushqimore, si dhe kushtet e menaxhimit dhe kontrollit të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor do të verifikojë çdo ditë numrin e personave që trajtohen me ushqim (forca ditore), për **50 racione ushqimore**.

Autoriteti Kontraktor do të kontrollojë:

- respektimin e orarit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit;
- zbatimin e normave të racioneve ushqimore;
- pastërtinë e ambienteve të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit.

Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet komisionit të ngritur me urdhër të Titullarit, do të regjistrojë sasinë ditore të racioneve të ardhura. Likuidimi i detyrimeve ndaj operatorit ekonomik do të kryhet sipas urdhrit përkatës të Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Detyrat: Sipas sasisë së Grafikut të shërbimeve të kërkuara

Shpërndarja: Çdo ditë .

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Qendra Komunitare Multidisiplinare

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1.Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë

arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nën ligjore.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*
2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilanci duhet të shoqërohet edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006“Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.(Deklarate në fazën e parë)
4. Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të prapambetura ndaj shoqërive Ujësjellës-Kanalizime, fakt i cili provohet me vërtetim zyrtar të lëshuar nga shoqëria përkatëse Ujësjellës-Kanalizime, në përputhje me legjislacionin në fuqi. .(Deklarate në fazën e parë)

Shënim: Për vërtetimin e pikes 3 dhe pikes 4 , kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentin e lartëpërmendur.

3 Kapaciteti teknik:

1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**.
 - a. Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur Kontraten e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni Shtetëror, për realizimin e plotë dhe të sukseshëm të kësaj kontrate.

- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikate; ISO 22000:2018 certifikatë e sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ose ekuivalente me të (e vlefshme), e lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën/certifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.*
3. Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të ketë jo më pak se 7 (shtatë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1.	Drejtes Teknik (Mercollog/Kimist/Tecnolog ushqimor)	1
2.	Kuzhinier	2
3.	Ndihmës Kuzhinier	2
4.	Punonjës shpërndarës ushqimesh/Shofer	2
	Total	7 (shtatë)

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Për drejtuesin teknik/(Mercollog/Kimist/Teknolog ushqimor) te paraqitet:

- Diplomë me profesion Mercollog/Kimist/Tecnolog ushqimor
- Kontrate pune perkatese.
- CV ose Libreze pune ose dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën përkatëse. Minimumi 1 (nje) vit pune në profesion.

b) Për Kuzhinierin të paraqitet:

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.
- Kontratë pune përkatëse.
- CV ose libreze pune ose dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën përkatëse. Minimumi të ketë 1 (nje) vit pune në profesion.

c) Ndihmës kuzhinier të paraqitet:

- Kontrate pune përkatëse.

d) Për punonjësit për shpërndarje ushqimi/Shofer,të paraqitet:

- Kontratë pune perkatese.
- Leje Drejtimi për mjedin e kërkuar, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.

- Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

Nr	Emër Mbiemër	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës
----	--------------	------------	---

Shënim 3.1:

Me qellim garantimin e gjithë perfshirjes, për ti dhënë mundësi cdo operatori ekonomik për të marrë pjesë në procedurën përkatëse të prokurimit, punonjësit e mësipërm jo domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Punonjësit mund të kontraktohen nga operatori ekonomik enkas për këtë procedurë prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të genë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Shënim: Për vërtetimin e pikes 3, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me **Deklarate nga operatori ekonomik per permbushjen e kesaj pike**, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftim fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentat e lartëpërmendura.

4.Operatori ekonomik duhet te paraqese **Deklarate** se disponon në pronësi ose me qera një mjet transporti qe kryhen transportin e produkteve ushqimore, produkteve frigoriferike, per te gjithë periudhen e realizimit te sherbimit objekt prokurimi.

Dokumentacioni që verteton disponimin e mjetit të transportit të nevojshëm për kryerjen e shërbimit(si më poshtë) do te paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit nga ofertuesi i kualifikuar i pari ,me kërkesë të autoritetit kontraktor.

a. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit;
2. leje qarkullimi;
3. certifikatën e kontrollit teknik;
4. siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);
5. certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).

b. Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet:

1. dokumenti qe verteton regjistrimin e tij;
2. leje qarkullimi;
3. certifikatën e kontrollit teknik,
4. siguracionin e mjetit,(i vlefshëm);
5. certifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).

Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt i ketij prokurimi.

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

e. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar. **(Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).**

f. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Leje/Akt Miratimi higjeno-sanitare për automjetin, e vlefshme për periudhën e realizimit të objektit të kontratës.

